



## Kërkesat dhe mrekullitë e dashurisë

“Dashuria nuk mbaron kurrë” (1 Kor 13,8) “Jetoni në dashuri, sikurse Krishti na deshi ne dhe për ne ia flijoi vetveten Hyjit porsì kusht e fli “që jep erë të mirë”” (Ef. 5,2)

At. Rikardo E. Façi

Të gjithë e dimë shumë mirë që kohët e fundit fjala dashuri është kthyer në një nga fjalët më të përdorura dhe më të keqpërdorura për të quajtur dashuri gjëra që nuk kanë të bëjnë me dashurinë. Për këtë arsye, në këtë letër do të reflektojmë se çfarë është dashuria.

Le të fillojmë këtë reflektim mbi atë që unë besoj se është karakteristika më e madhe e dashurisë, e gjithë dashurisë: takimi me tjetrin.

Një gabim shumë aktual është të kërkosh në emër të dashurisë zotërimin e tjetrit dhe jo takimin, duke pasur parasysh se çdo takim duhet të lindë nga një dhurim. Dashuria është e lirë, nuk mund të kërkohet e as të pritët, por duhet të jesh i pari që dashuron. Kjo është arsyeja pse ne themi se për të gjetur dashurinë, duhet të japësh dashuri. Dashuria lind dhe zhvillohet nga dhënia. Nëse nuk japim, nuk do ta zbulojmë kurrë dashurinë e vërtetë. Për më tepër, dashuria është mohimi i vetes dhe pranimi i tjetrit. Përveç kësaj, nga përvoja ne me siguri e dimë se, që dashuria të piqet, ajo duhet të kalojë kufirin e vuajtjes. Pra, dashuria kërkon heqje dorë.

Një nga bukuritë e dashurisë është se ajo nuk plakët, por piqet, është si vera, sa më e vjetër aq më mirë, pasi merr një shije tjetër, një trashësi tjetër. Dashuria, sidomos ajo martesore, ka nevojë për durim, kohë. Në të gjitha çiftet duhet të kalohet nga realiteti në ideal. Është e nevojshme të ecim nëpër realitet me vështrimin tonë të drejtuar drejt idealit, asnjëherë anasjelltas.

Kërkesa më e madhe e dashurisë është të japësh derisa të dhemb. Dashuria autentike dhemb gjithmonë, ajo shoqërohet gjithmonë me situata që lëndojnë. Kur dikush dëshiron të ndërtojë jetën nga dashuria, dhemb deri në thelbin më intim.

Në letrën e parë drejtuar Korintasve, Shën Pali thekson se dashuria është baza e të gjitha veprimeve dhe qëndrimeve të krishtera. Na mëson se zgjedhja e dashurisë bëhet një mënyrë jetese.

Dinamika e dashurisë si takim me tjetrin na bën të theksojmë rëndësinë e të qenit aty për tjetrin, për bashkëshortin. Kjo do të thotë të jesh gjithmonë i gatshëm të bëhesh i vetëdijshëm për praninë e tjetrit, dhuntitë dhe cilësitë e tij të mira, duke ditur t'i admirosh më shumë çdo ditë.

Çelësi i gjithçkaje është të jesh i qartë se je "gjithmonë për tjetrin".

Kur dikush martohet, ia kushton veten tjetrit. Por, fakti i të qenit aty për tjetrin, edhe pse tingëllon si diçka shumë e bukur, është ndoshta gjëja më e vështirë në jetë. Të jesh për tjetrin do të thotë se ke hequr dorë lirisht nga e drejta për të menduar për veten tënde, për rehatinë tënde, por që duhet të marrësh përsipër një detyrë: faktin e harrimit të vetvetes, ashtu si Krishti harron veten për t'i dhënë Kishës.

Misioni i madh është të drejtosh "më të mirin në botë" që të bëhet "më i miri në qiell". Nuk është aspak e lehtë. Ju e dini më mirë se unë, sepse ne jemi egoistë, zemërgushtë, individualistë, materialistë. Kur gjejmë dikë që vërtet jeton për tjetrin, mund të themi se jemi përballë dikujt që ka ndërtuar shenjtërinë në jetën e tij.

Kjo është ajo që Jezu Krishti na mësoi për dashurinë: të jetosh për tjetrin me përkushtim të madh, me një dashuri fisnike, transparente, jo me qëndrimin e dikujt që kërkon që tjetri të jetojë "për mua". Çifti do të jetë i lumtur në masën që do të jetojë sipas këtij ligji të dashurisë autentike.

Dashuria ndikon edhe në shijet... Atij i pëlqen të hajë mish, e asaj makarona... Ai duhet ta dijë që është i dënuar të hajë makarona gjithë jetën. Do të durojë për një javë. Por... a do të jetë në gjendje ta pranojë atë për 10 vjet, 20 vjet, 60 vjet, nëse Zoti u jep atyre gjithë atë kohë? Ndoshta, kur e lexojmë këtë, na duket për të qeshur sepse kjo u ndodh disave. Por duhet të dimë se këtu është çelësi i lumturisë apo dështimit martesor. Ndoshta mund ta zgjidhim shpejt duke thënë: 3 ditë mish dhe 3 ditë makarona. Por dashuria nuk përcaktohet nga llogaritjet matematikore apo spekulimet për të shpërndarë në mënyrë të barabartë 50% dhe 50%, tre ditë në favor të njërit dhe tre ditë në favor të tjetrit. Ose mund të jetë gjithashtu që çdo ditë ka mish ose çdo ditë ka makarona. Por, këmbëngul sërish, dashuria është përqendrimi tek tjetri dhe jo tek vetja.

Por është dikush që është gjithmonë gati të na prishë dëshirat tona më të mira. Ky është djalli. Kjo qenie nuk është një përrallë, një përfaqësim, një simbol, një figurë apo një ide. Ky vetë-mashtrim na bën të ulim krahët, të neglizhojmë veten dhe të bëhemi më të pambrojtur. I ligu nuk ka nevojë të na

zotërojë, por na helmon me urrejtje, trishtim, zili, vese. Dhe kështu, ndërsa ne e humbasim vigjilencën, ai përfiton nga rasti për të shkatërruar jetën tonë, familjet tona dhe komunitetet tona, sepse “si një luan ulëritës, ai endet këndeje dhe andej duke kërkuar kë të përpijë” (1Pj 5,8).

Dashuria është sakrificë, dorëzim, vdekje e vetes, siç thamë, është një dhënie e dhimbshme ndaj tjetrit. Bota na ofron të kundërtën: kënaqësi, shpërqendrim, argëtim dhe na thotë se kjo është ajo që e bën jetën të mirë. Njeriu i kësaj bote injoron dhe shikon diku tjetër kur ka probleme sëmundjeje ose dhimbjeje në familje ose rreth tij. Bota nuk dëshiron të qajë: preferon të injorojë situatat e dhimbshme, t'i mbulojë, t'i fshehë ato. Shumë energji shpenzohet për të ikur dhe për t'iu shmangur rrethanave ku vuajtja është e pranishme, duke besuar se është e mundur të fshihet realiteti, ku kryqi nuk mund të mungojë kurrë, kurrë.<sup>1</sup> Dashuria është një kryq, një kryq triumfues që të çon në lumturi.

Të jetosh për bashkëshortin tënd do të thotë të jesh gjithmonë i gatshëm të ndërgjegjësohesh për tjetrin, nevojat dhe cilësitë e mira që ka.

Jeta bashkëshortore përbëhet nga shumë detaje të vogla të përditshme. Bashkëshortët duhet të mësohen me shumë gjëra, por kurrë të mos mësohen me cilësitë e mira të bashkëshortit, por të mësojnë t'i vlerësojnë ato çdo ditë e më shumë. Por nëse bashkëshortët mësohen me cilësitë e mira të tjetrit, vëmendja e tyre mund të tërhiqet nga defektet, cilësitë e këqija, duke rrezikuar që negativia të mbysë pozitiven që ka tek tjetri.

Prandaj themi se lumturia martesore varet nga fryma e sakrificës, nga aftësia për të lejuar që të kryqëzohet nga tjetri. Është rruga e dashurisë së vërtetë ajo që është gjëja më e vështirë në këtë jetë. Po, më e vështira; detyra më e vështirë që duhet të mësojmë të gjithë, pavarësisht nga thjrra jonë, është të mësojmë të duam. Gjëja më e vështirë për qeniet njerëzore është të harrojnë veten dhe të kthehen drejt të tjerëve, drejt tjetrit.

### Lutja

Zoti Jezus,  
në kryq na ke dhënë masën e dashurisë  
dhe pas ringjalljes na mësove se si ajo dashuri mbetet përgjithmonë;  
të kërkojmë që dashuria e martesës sonë  
t'i përgjigjet gjithmonë kërkesave të heqjes dorë,  
që në të të shkëlqejë fryma e dritës,  
forca, bujaria dhe përkushtimi pa masë,  
për të ndërtuar lumturinë së bashku,  
në këtë pelegrinazh dhe në jetën e përvetshme.  
Amen.

### Puna Martesore

- 1.- A jemi të përgatitur të sakrifikojmë shijet tona personale apo vazhdojmë të këmbëngulim derisa t'i imponojmë ato?
2. A vazhdojmë të shohim cilësitë dhe aspektet pozitive të bashkëshortit, apo janë harruar?
3. A është më e lehtë për ne të shohim negativën, duke lënë në hije virtytet e tjetrit?
4. A ruajmë një dashuri të re dhe të pjekur?

### Puna Shtyllë

- 1.- A e kemi të qartë manipulimin aktual të fjalës "dashuri"?
- 2.- Si të edukohen brezat e rini në kuptimin e vërtetë të "dashurisë" si dorëzim dhe heqje dorë personale për të qenë në gjendje të vlerësojmë tjetrin?
- 3.- Në shtëpitë tona, a kemi qenë dëshmitarë se dashuria është sakrificë dhe përkushtim më shumë sesa "ngjyra e qiellit"?
- 4.- Nga një koncept i thellë i "dashurisë", si e quajmë kalimin nga "më i miri në botë" tek "më i miri në qiell"?

**Shenimet:** 1.- Krh. Françesko, "Gaudete et Exsultate" 161, 75.